

KRONIKË SHKENCORE E AKTIVITETEVE TË DEGËS SË GJUHËSISË TË INSTITUTIT ALBANOLOGJIK-PRISHTINË PËR VITIN 2024

Gjatë vitit 2024, Dega e Gjuhësisë e Institutit Albanologjik i ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara në planin e punës për vitin 2024. Punonjësit e Degës së Gjuhësisë me përkushtim dhe angazhim profesional organizuan dhe morën pjesë në shumë konferenca e tryeza shkencore.

Tryeza shkencore "Profesor Jup Kastrati: Personalitet i shquar i albanologjisë (1924-2024)"

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së prof. Jup Kastratit, Dega e Gjuhësisë më 25 prill, 2024, organizoi Tryezën shkencore "Profesor Jup Kastrati: Personalitet i shquar i albanologjisë (1924-2024)".

Me kumtesa u paraqitën këta studiues e studiuese:

Prof. dr. Begzad Baliu: *Profesor Jup Kastrati: Jeta dhe vepra (1924-2024)*;

Prof. dr. Isak Shema, *Vlerësimet e Profesor Jup Kastratit për Faik Konicën*;

Prof. dr. Agim Vinca: *Profesor Jup Kastratin - pengu i një premtimi*;

Prof. asoc. dr. Abdurrahman Maxhuni, *Gramatikat e rilindësve në veprën e Jup Kastratit*;

Prof. dr. Diana Jup Kastrati, *Mbarëkombëtarja e Profesor Jup Kastratit: nga arbëreshët tek Faik Konica dhe nga rilindësit të Kosova*;

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj Baliu, *Studimet e Profesor Jup Kastratit për De Radën*

Prof. ass.dr. Faton Krasniqi, *Profesor Jup Kastrati bibliografist dhe historian i albanologjisë*;

Dr. Fatmire Jup Kastrati, *Trashëgimia albanologjike e Profesor Jup kastratit dhe interesi shkencor*;

Seancën e drejtuan: Prof. dr. Begzad Baliu, prof. ass. dr. Faton Krasniqi, prof.asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni. Fjala e hapjes: Prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni. Fjalë përshëndetëse: Dr. Fatmira Jup Kastrati, *Përshëndetje në emër të familjes së Jup Kastratit*. Fjala e mbylljes: Prof. ass.dr. Faton Krasniqi.

Panairi i 3-të Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor

Në datat 23-25 prill 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Tiranë, u mbajt Panairi i 3-të Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor. Në kuadër të këtij Panairi, më 25 prill 2024, u promovua kolana me 12 vepra e akad. Jani Thomait, njërit nga personalitetet më të rëndësishme të botës shkencore shqiptare. Në kuadër të kësaj kolane, në librin XII, është përfshirë vëllimi I i përmbledhjes “Albanologji”¹¹/2020, ku botohen aktet e konferencës shkencore tradicionale të Institutit Albanologjik të Prishtinës, “Java e Albanologjisë”. Në këtë aktivitet, Sesiioni i Gjuhësisë në kuadër të Konferencës, me titull “Leksikografia shqipe-zhvillime dhe sfida”, i qe kushtuar akademik Jani Thomait në 85-vjetorin e lindjes. Në këto vepra punimet e tyre studimore nga Dega e Gjuhësisë i botuan këta studiues: Naim Berisha, Vjosa Osmani, Abdurrahim Maxhuni, Shpresa Ismajli, Faton Krasniqi, Sejdi Gashi dhe Adelina Selmani.

Në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në Panairin e 3-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, organizim i dy akademive tona, më 24 prill u promovua veprimtaria shkencore e Institutit Albanologjik. Prezantimin e bëri u.d. i Drejtorit të IAP, prof. dr. Lulëzim Lajçi, kurse për veprën *Fjalor toponomastik i Kosovës* foli prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni.

Tryeza shkencore "Kontributi i profesor Jup Kastratit në Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe"

Më 25 prill 2024, punonjësit shkencorë të Degës së Gjuhësisë në IAP, prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni dhe prof. ass. dr. Faton Krasniqi morën pjesë në Tryezën shkencore: "Kontributi i profesor Jup Kastratit në Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe", të organizuar nga klubi letrar "De Rada", Ferizaj.

Konferenca shkencore "Evolucioni Gjuhësor në Epokën Digjitale: Impakti në Komunikim, Letërsi, Qytetërim dhe Mësimdhënie"

Më 10 maj 2024, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u organizua Konferenca shkencore: "Evolucioni Gjuhësor në Epokën Digjitale: Impakti në Komunikim, Letërsi, Qytetërim dhe Mësimdhënie". Me kumtesa nga Dega e Gjuhësisë u paraqitën këta studiues: Prof. asoc. dr. Naim Berisha, prof.asoc.dr. Abdurrahim Maxhuni, prof. ass. dr. Faton Krasniqi, prof. ass. dr. Sejdi Gashi, prof. ass. dr. Vjosa Osmani dhe prof. ass. dr. Afërdita Abdullahi Dërmaku.

Promovimi i librit "Çështje sociolinguistike të terminologjisë në mediet e Kosovës dhe të Shqipërisë"

Më 3 maj 2024, në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, në Komunën e Istogut (Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport), u organizua promovimi i librit "Çështje sociolinguistike të terminologjisë në mediet e Kosovës dhe të Shqipërisë", i autorit prof. ass.dr. Sejdi Gashit, punonjës shkencor në Degën e Gjuhësisë. Në emër të Degës së Gjuhësisë aktivitetin e përshëndeti, prof. ass. dr. Faton Krasniqi. Për librin folën dy recensentët, prof. dr. Mustafa Ibrahimimi dhe prof. asoc. dr. Naim Berisha.

Vijon puna në hartimin e veprës "Fjalor i Madh i Gjuhës Shqipe"

Në kuadër të projektit "Fjalor i Madh i Gjuhës Shqipe" me rreth 110.000 fjalë e togfjalësha të qëndrueshëm e me mbi 11.000 njësi frazeologjike, drejtuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Prishtinës, më datë: 18 korrik 2024, u mbajt takimi i radhës për hartimin e veprës. Grupi i punës nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) përbëhej nga akad. prof. dr. Valter Memisha (Sekretar shkencor i Fjalorit dhe hartues), prof. asoc. dr. Anila Kananaj (hartuese dhe koordinatore), msc. Engjëllushe Karaj (hartuese). Ndërkaq, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës morën pjesë studiuesit, prof. dr. Shefkije Islamaj (hartuese dhe anëtare e redaksisë së Fjalorit), prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni (Shef i Degës së Gjuhësisë dhe hartues), prof. asoc. dr. Naim Berisha (hartues) dhe prof. ass. dr. Sejdi M. Gashi (hartues).

Takimi kishte karakter konsultativ në drejtim të përfundimit të punës hartuese në Fjalor.

Grupi diskutoi gjerësisht dhe me përgjegjësi për punën në fazën e tanishme, kur po mbyllet procesi hartues dhe redaktimi brenda grupit, dhe kur po merr përparësi sistematizimi i lëndës së hartuar dhe unifikimi i paraqitjes leksikografike. Gjithashtu, u dha porosia se vepra nuk quhet e mbyllur, por secili hartues duhet të pasurojë shkronjën, shkronjat e veta me fjalë, kuptime e thënie ilustruese në vazhdimësi.

Konferenca shkencore "Java e Albanologjisë", 15/2024

Në kuadër të Konferencës shkencore "Java e Albanologjisë", i zhvilloi punimet Sesioni i gjuhësisë me temën bosht "Drejtskrimi i shqipes 60 vjet pas Ortografisë së Prishtinës". Në këtë sesion u paraqitën 22 kumtues, në mesin e të cilëve 7 punonjës shkencorë të Degës së Gjuhësisë.

Në këtë konferencë morën pjesë këta studiues:

Emil Lafe, *Shqyrtime rreth përjashtimeve nga rregullat në "Drejtshkrimin e gjuhës shqipe"*;

Xhevat Lloshi, *Konsulta e Prishtinës mes dy gjysmëshekujve* ;

Berton Sulejmani, *Norma gjuhësore dhe roli i gazetës "Flaka e Vllazërimit" pas ortografisë së Prishtinës (1964)*;

Asllan Hamiti, *Përditësimi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*;

Edlira Tropilini Abdurrahmani, *Gjuha standarde shqipe dhe kompetenca ligjërimore përballë sfidave të kohës*;

Ismet Osmani, *Pikëpamjet e gjuhëtarëve shqiptarë nga RMV pjesëmarrës në Konsultën e Prishtinës*;

Begzad Baliu, *Diskutimet mbi drejtshkrimet e gjuhës shqipe gjatë shekullit XX*;

Naim Berisha, *Roli i Ortografisë së Prishtinës (1964) në standardizimin e shqipes*;

Vjosa Osmani, *Pikëpamje për përzgjedhjen e korpusit dhe planifikimit të shqipes në Kosovë (1952-1968)* ;

Davida Marku, *Komisia Letrare e Shkodrës dhe rruga për standardizimin e shqipes*;

Sejdi Gashi, *Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) – përmasat shkencore dhe politike të saj*;

Faton Krasniqi, *Mosrespektimi i pjesëzës mohuese s' në disa shkrime publike e mediale*;

Hana Dardhishta, *Marrëdhëniet e ndërsjella të standardit me njësitë dialektore*;

Shkëlqim Millaku, *Pikëpamjet e Selman Rizës për shqipen*;

Shemi Haziri – Senad Neziri, *Disa shmangie drejtshkrimore në gjuhën shqipe në kontekstin aktual*;

Afërdita Abdullahi, *Kontributi i Idriz Ajetit për ortografinë e shqipes* ;

Migena Arllati, *Përmirësime në drejtshkrimin e disa mbiemrave familjarë*;

Abdurrahim Maxhuni, *Pikëpamjet e prof. Xhevat Lloshit për drejtshkrimin e shqipes*;

Qëndrim Morina, *Dukuria e rimarrjes së kundrinës në emisionet televizive në Kosovë*;

Florina Çitaku, *Zhvillimi historik dhe roli i alfabeteve të shqipes për standardizimin*;

Brunilda Ozuni, *Drejtshkrimi, ndryshimet që ka pësuar vitet e fundit në institucionet dhe përditshmëritë*.

Seminari XVIII i Albanologjisë

Më datë 25 shtator 2024 i zhvilloi punimet Seminari XVIII i Albanologjisë, organizuar nga Universiteti i Tetovës. Temë bosht e këtij edicioni ishte: "Kontributi i Rexhep Qosjes për letërsinë dhe kulturën shqiptare".

Studiuesit nga Instituti Albanologjik-Prishtinë (Dega e Gjuhësisë) që morën pjesë në këtë aktivitet të rëndësishëm shkencor janë: Dr. Shpresa Ismajli, "Rexhep Qosja, pasurues i shqipes standarde", dr. Abdurrahim Maxhuni, "Profesoreshë Shefkije Islamaj për gjuhën e Rexhep Qosjes", dr. Sejdi Gashi "Pikëpamjet e akademik Rexhep Qosjes për shqipen standarde", dr. Faton Krasniqi, dr. Naim Berisha "Fjalëformimi në krijimtarinë letrare të Rexhep Qosjes".

Konferenca shkencore "Etnokultura e trevës së Tetovës"

Shoqëria e Kulturës Shqiptare "Etnoalb", organizoi edicionin e VII të konferencës shkencore me temën "Etnokultura e trevës së Tetovës". Kjo konferencë u mbajt më 4 dhe 5 tetor 2024, në qytetin e Tetovës. Nga Dega e Gjuhësisë me kumtesë u paraqit studiuesja, dr. Afërdita Abdullahu Dërmaku me kumtesën e saj "Vështrim etnolinguistik mbi emërtimet e veshjeve në Rrafsh të Dukagjinit dhe në trevën e Tetovës".

Konferenca shkencore "Balkan Parallells"

Më 17 dhe 18 tetor 2024, prof. asoc. dr. Naim Berisha dhe prof. ass. Afërdita Abdullahu Dërmaku morën pjesë në Konferencën shkencore "Balkan Parallells", që u organizua nga Universiteti i Sofjes "St. Kliment Ohridski", në shënim të 30- vjetorit të studimeve ballkanistike në universitetin e lartpërmendur.

Simpoziumi shkencor "Gjuha dhe identiteti kombëtar"

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" – Elbasan, në bashkëpunim me Institutin Albanologjik – Prishtinë, më 12 dhe 13 nëntor 2024, organizuan simpoziumin shkencor "Gjuha dhe identiteti kombëtar". Në këtë simpozium nga Dega e Gjuhësisë morën pjesë këta studiues: Prof. asoc. dr. Naim Berisha, prof. asoc. dr. Abdurrahim, prof. ass. dr. Sejdi Gashi. U. d. i drejtorit të Institutit Albanologjik, dr. Naim Berisha, mbajti një fjalë rasti në hapjen solemne të këtij simpoziumi shkencor.

"Alfabeti shqip dhe identiteti kombëtar" (seminar)

Më datë 18 nëntor 2024, Departamenti i Historisë i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Fakultetin e Shkencave Sociale nga Universiteti i Shkodrës dhe Institutin Albanologjik - Prishtinë organizuan seminarin me titull "Alfabeti shqip dhe identiteti kombëtar". Ky seminar u mbajt në Fakultetin Filozofik-UP. Në këtë seminar nga Dega e Gjuhësisë mori pjesë dr. Abdurrahim Maxhuni, bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin Albanologjik. Ky seminar u organizua në nderim të përvjetorit të Kongresit të Manastirit dhe në të njëjtën kohë ishte në vazhden e aktiviteteve për 80- vjetorin e çlirimit të Shqipërisë.

Konferenca shkencore “Zhvillimi i arsimit shqiptar dhe gjuha shqipe”

Më 18 dhe 19 nëntor 2024, në Manastir, në qytetin e Alfabetit, për nder të Festës së “22 Nëntorit” u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temën “Zhvillimi i arsimit shqiptar dhe gjuha shqipe”. Në këtë konferencë morën pjesë me dhjetëra pjesëmarrës nga disa universitete dhe institute shqiptare nga vendi, Kosova dhe Shqipëria.

Hapja e Konferencës u bë në sallën e Muzeut, ku pas ceremonisë së përshëndetjeve, për kontributin e dhënë, organizatorët ndanë plaketa me pamjen e objektit të Muzeut të Alfabetit në Manastir. Në hapjen solemne të kësaj konference me fjalë përshëndetëse u paraqiten edhe kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Afrim Gashi, e para e Ministrisë së Arsimit në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, znj. Ogerta Manastirliu dhe personalitete të ndryshme nga bota akademike dhe kulturore shqiptare. Në hapjen solemne të kësaj konferencë, dr. Naim Berisha, u.d. i drejtorit të Institutit Albanologjik-Prishtinë, mbajti një fjalë përshëndetëse.

Kuvendi Kombëtar për Gjuhën Shqipe “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI”

Në kuadër të Kuvendit Kombëtar për Gjuhën Shqipe “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI”, i mbajtur në Tiranë, më datat 21 dhe 22 nëntor 2024, u bë promovimi i Projektit “Fjalor i Madh i Gjuhës Shqipe”. Në këtë aktivitet promovues të një projekti të rëndësishëm për gjuhën tonë, nga Instituti Albanologjik morën pjesë: Dr. Naim Berisha, dr. Abdurrahim Maxhuni, dr. Sejdi Gashi. Në këtë projekt Instituti Albanologjik-Prishtinë është i përfshirë në mënyrë institucionale përmes marrëveshjes me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në projektin “Fjalor i Madh i Gjuhës Shqipe”, në cilësinë e anëtarit të redaksisë, përgjegjësit për Kartotekën e Leksikut të

Shqipes në Kosovë, hartuesve dhe bashkëpunëtorëve, kanë qenë të përfshirë këta punonjës dhe ish-punonjës shkencorë të Institutit Albanologjik: Shefkije Islamaj, Qemal Murati, Naim Berisha, Abdurrahim Maxhuni, Sejdi Gashi, Shpresa Ismaili Aliu, Afërdita Abdullahi Dërmaku, Adelinë Selmani.

Pas prezantimit të “Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe”, u.d. i drejtorit të IAP, dr. Naim Berisha, mori pjesë në panelin e diskutimit “Gjuha shqipe në studimet shqiptare dhe roli i saj në formimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar”.

Konferenca shkencore “Shkodra në shekuj: trashëgimi e gjallë dhe fuqi krijuese në historinë kombëtare”

Më 12 dhe 13 dhjetor 2024, punonjësit shkencorë të Degës së Gjuhësisë në IAP: prof. asoc. dr. Naim Berisha, prof. asoc. Abdurrahim Maxhuni, prof. ass. dr. Sejdi Gashi dhe prof. ass. dr. Faton Krasniqi, morën pjesë në Konferencën shkencore: “Shkodra në shekuj: trashëgimi e gjallë dhe fuqi krijuese në historinë kombëtare”. Këtë konferencë e organizoi Universiteti Shtetëror “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Botime të veçanta në vitin 2024

REVISTA SHKENCORE

1. “Gjuha shqipe”, 1- 2024.
2. “Gjuha shqipe”, 2 - 2024.
3. “Gjuha shqipe”, 3 - 2024.
4. “Kumtime gjuhësore”, III - Aktet e tryezës shkencore: “Profesor Jup Kastrati: personalitet i shquar i albanologjisë (1924-2024)”.
5. “Gjurmime Albanologjike”, -seria e shkencave filologjike, nr. 54/2024.
6. “Albanologjia”, 15/2024.

Publikime të veçanta në vitin 2024

1. Hajro Ulqinaku, *Peshqit e Detit tonë*, Instituti Albanologjik – Prishtinë, 2024 (Glosar i iktiologjisë).
2. Sejdi Gashi, *Çështje sociolinguistike të terminologjisë në mediet e Kosovës dhe të Shqipërisë*, Instituti Albanologjik – Prishtinë, 2024 (monografi).
3. Abdurrahim Maxhuni, *Fjalor dialektor i së folmes shqipe së Vushtrrisë*, Instituti Albanologjik- Prishtinë, 2024 (fjalor dialektor).
4. Naim Berisha, *Studime për shqipen*, Instituti Albanologjik- Prishtinë, 2024 (përmbledhje studimore).
5. Afërdita Abdullahi Dermaku, *Njësi frazeologjike dhe shprehje popullore në të folmet e Kosovës (Rrafshi i Dukagjinit dhe më gjerë)*, Instituti Albanologjik- Prishtinë, 2024 (Fjalor).

Faton KRASNIQI